

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

Pml.nr.106/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Afrim Shala dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit A. G., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.9 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, av. Blerim Ademaj, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, PKR.PP.nr.114/23 të datës 25.01.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.101/2024 të datës 31.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 20.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit A. G., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, PKR.PP.nr.114/23 të datës 25.01.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.101/2024 të datës 31.01.2024.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.PP.nr. 114/23 të datës 25.01.2024, të pandehurit A. G., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.9 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, e cila masë do t'i zgjasë nga data 25.01.2024 deri më datën 24.03.2024. Masa e paraburgimit i është vazhduar në bazë të nenit 184 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës penale (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.1.nr.101/2024 të datës 31.01.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit A. G., av. Blerim Ademaj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara, ashtu që të pandehurit t'i ndërprehet masa e paraburgimit.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.43/2024 të datës 15.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1. të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit thekson se të dy aktvendimet e kundërshtuara janë të pakuptueshëm dhe kundërtshënës në brendinë e tyre ngase nuk përfshijnë arsyetimin dhe nuk kanë paraqitur arsyet në lidhje me faktet vendimtare. Nuk ka dyshim të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet sepse në rastin konkret nuk vërtetohet me asnjë provë të drejtpërdrejtë që e ndërlidhë të pandehurin me veprën penale. I pandehuri nuk ka se si të ndikojë në dëshmitarët, ndërsa gjykata nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm lidhur me këtë pikë, po ashtu edhe sa i përket arsyetimit lidhur me përsëritjen e veprës penale është i pabazuar pasi që gjykatat e instancave më të ulëta e kanë paragjykuar epilogun e këtij rasti ende pa u administruar asnjë provë.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga kallëzimi penal me numër të rastit .... të datës 26.12.2023, aktvendimit për fillimin e hetimeve .... të datës 26.12.2023, dhe shkresave tjera në lëndë, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri dyshohet se ka kryer veprën penale për të cilën pandehet, kurse a do të argumentohen këto fakte e prova do të vlerësohet në fazat e ardhme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184, paragrafi 1. nën paragrafi 1.1. e 1.2. të KPP-së.

Kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, par. 1. nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPP-së, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, duke pasur parasysh faktin se vepra penale për të cilën dyshohet është e natyrës së rëndë, për të cilën, nëse i njëjti shpallet fajtor, parashihen dënime mjaft të larta, si dhe fakti se i njëjti nga momenti i kryerjes së veprës penale ka qenë në arrati deri më datën 26.12.2023, andaj me gjetjen e tij në liri do të mund të arratiset me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësojnë zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par.1 nën par.1.2 pika 1.2.2 të KPP-së, sepse procedura penale është ende në fazën e hetimeve dhe në zbardhjen e rastit në tërësi, janë duke u mbledhur ende provat materiale siç janë verifikimi i kamerave të sigurisë të shtëpive përreth lagjes ku ka ndodhur ngjarja, do të dëgjohet i dëmtuari-dëshmitari A. Sh. si dhe do të dëgjohet dëshmitari M.H. zyrtari policor, andaj po të gjendej i pandehuri në liri ekziston rreziku i ndikimit në dëshmitarët apo mund të asgjësoj, dëmtoj ose fshehtë provat materiale, e në këtë mënyrë do të pengohet rrjedha normale e procedurës penale.

Gjithashtu, kjo Gjykatë i gjen si të pabazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, nga se ka bazë ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.2 pika 1.2.3 të KPP-së, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, karakteristikat personale të të pandehurit dhe sjellja e tij e mëparshme ngase nga data baza e policisë i njëjti dyshohet për disa vepra të ndryshme penale, ndërsa sipas data bazës së prokurorisë ndaj të njëjti janë ngritur 10 aktakuza për vepra të ndryshme penale, rrethana këto të cilat tregojnë se po të gjendet i pandehuri në liri ekziston rreziku se do të mund të përsërit veprën penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, andaj vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.106/2023, më 20.02.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetare e kolegjit,  
Valdete Daka